Vlerësimi institucional me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset

Shkolla Profesionale “Teknike” Korçë

Viti shkollor 2025 – 2026

Shtator 2026

Tabela e përmbajtjes

Lista e Tabelave 3

Hyrje 5

Metodologjia 5

Të dhëna për pjesëmarrësit 7

Rezultatet 7

- Zhvillimi i vazhduar profesional 7
- Kurrikula 8
- Marrëdhënia me biznesit 9
- Orientimi në karrierë 10
- Projektet 10
- Marketingu 11
- Gjurmimi në nivel ofruesi 12

Shtojca 1 – Tabela exel me të dhënat nga sondazhi 14

Shtojca 2 – Pyetësorët ..... **Error! Bookmark not defined.**

Lista e Tabelave

Tabela 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup 7
Tabela 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional 8
Tabela 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës 8
Tabela 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin 9
Tabela 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë 10
Tabela 6: Rezultatet për treguesit e projekteve 10
Tabela 7: Rezultatet për treguesit e marketingut 11
Tabela 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi 12

© 2026 Swisscontact

Rreth projektit "Aftësi për Punë" (S4J)

Aftësi për Punë (S4J) është një projekt i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) i zbatuar nga Swisscontact, i cili synon të adresojë sfidat kryesore në Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) në Shqipëri. Që prej tetorit 2015, projekti "Aftësi për Punë" (S4J) mbështet qeverinë dhe aktorët e tjerë të interesit për të ndërtuar një sistem cilësor të AFP në Shqipëri, i frymëzuar nga modeli zviceran. Në fazën e tij të tretë (2024-2027), me theks të veçantë tek qëndrueshmëria, projekti është angazhuar në ndarjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive dhe përvojave të përftuara në nivel sistemi, në bashkëpunim të ngushtë me shkollat partnere.

Hyrje

Ky raport paraqet gjetjet nga procesi i **Vlerësimit Institucional** të zhvilluar në Shkollën **Profesionale Teknike Korçë** për vitin shkollor 2025 - 2026. Procesi, me synim vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të aftësimit profesional, përfshiu nxënës, mësues, prindër dhe biznese partnere, të cilët u anketuan gjatë periudhës maj-qershor 2026.

Procesi u koordinua nga Njësia e Zhvillimit (NjZH) në shkollë, e cila luan një rol kyç në monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimeve. Përshkrimi i gjetjeve në raport është i organizuar sipas treguesve për secilin funksion të NJZH-së.

Ky proces vlerësues mbështetet në përvojën e vitit shkollor 2023 - 2024, ku projekti 'Aftësi për Punë' (S4J), në bashkëpunim me gjashtë shkolla partnere[1], zhvilloi katër instrumente vlerësimi (pyetësorë), të bazuar në një metodologji rigoroze dhe pjesëmarrëse. Pas pilotimit në gjashtë shkolla, instrumentet u rishikuan për të garantuar vlefshmëri, qëndrueshmëri dhe respektim të standardeve etike[2].

Metodologjia

Në kuadër të mbledhjes së informacionit që do të ushqejë analizën vjetore të performancës institucionale, në përfundim të çdo viti shkollor do të realizohet një proces vlerësimi institucional në nivel ofruesi duke përfshirë katër grupeve kryesore: nxënës, mësues, biznese dhe prindër. Ky proces synon të vlerësojë performancën institucionale, të identifikojë fushat për përmirësim dhe të informojë objektivat e planit vjetor të institucionit.
Për këtë qëllim, janë zhvilluar katër instrumente vlerësimi (pyetësor), si vijon:

Pyetësori për nxënësit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e nxënësve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në cilësinë e mësimdhënies, praktikën profesionale, orientimin në karrierë dhe performancën e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i programeve për të përgatitur më mirë nxënësit për tregun e punës.

Pyetësori për mësuesit synon të mbledh mendimet dhe përvojat e mësuesve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional dhe mjedisit të të nxënit. Fokusohet në zhvillimin profesional, zbërthimin e kurrikulës, projektet zhvillimore dhe dhe performancën e institucionit. Qëllimi është identifikimi i fushave për përmirësim dhe përshtatja e praktikave me nevojat e stafit dhe nxënësve.

Pyetësori për bizneset synon të mbledh perceptimet e bizneseve për cilësinë e bashkëpunimit me institucionin dhe përvojën me nxënësit gjatë praktikës profesionale. Fokusohet në përgatitjen e nxënësve, përputhshmërinë e programeve të praktikës me nevojat e tregut të punës dhe mundësitë për përmirësim.

---

[1] Hamdi Bushati, Kolin Gjoka, Kristo Isak, Shkolla Profesionale Elbasan, Shkolla Teknike Ekonomike Tirane, Tregtare.
[2] Për më shumë informacion, shih raportin Baseline i treguesve të cilësisë së Njësisë së Zhvillimit
https://skillsforjobs.al/publications/baseline-i-treguesve-te-cilesise-se-njesise-se-zhvillimit/

Qëllimi është forcimi i bashkëpunimit dhe angazhimi cilësor i sektorit privat në proceset e aftësimit profesional.

Pyetësori për prindërit synon të mbledhë mendimet e prindërve për cilësinë e shërbimeve të aftësimit profesional. Fokusohet në komunikimin me shkollën, orientimin në karrierë të fëmijëve dhe imazhin e institucionit. Qëllimi është përmirësimi i shërbimeve për të përmbushur pritshmëritë dhe nevojat e nxënësve dhe prindërve.

Të dhëna për pjesëmarrësit

Për vitin shkollor 2025-2026, në shkollën profesionale "Teknike Korçë" 332 nxënës morën pjesë në sondazh. Nga këta, 94% (N=312) ishin djem, 4.8% (N=16) ishin vajza. Të shpërndarë sipas klasave, 31.3% (N=104) e të anketuarve janë në klasën e dhjetë, 24% (N=80) në klasën e njëmbëdhjetë, 24% (N=80) në klasën e dymbëdhjetë, 18.7% (N=62) në klasën e trembëdhjetë dhe 0.9% (N=3) arsim profesional pas të mesëm.

Ndërkohë, 21 mësues morën pjesë në anketim. Nga këta mësues të përfshirë në anketim 38.1% (N=8) janë femra dhe 61.9% (N=13) janë meshkuj. Të ndarë sipas grup lëndëve që japin mësim 33.3% (N=7) japin lëndë të teorisë profesionale, 47.6% (N=10) japin njëkohësisht lëndë të teorisë profesionale dhe module të praktikës profesionale dhe 19% (N=4) japin module të praktikës profesionale

Në sondazh kanë marrë pjesë 48 biznese, nga ku 68.8% (N=33) e tyre shprehen se kanë patur bashkëpunim të ngushtë me shkollën gjatë këtij viti shkollor, dhe 70.8% (N=34) janë shumë të kënaqur me praktikat profesionale.

Në shkollën profesionale "Teknike" kanë marr pjesë në sondazh 94 prindër. Nga këta 57.3% (N=55) janë femra dhe 40.6% (N=39) janë meshkuj. Të shpërndarë sipas klasës që ndjek fëmija, 25% (N=24) kanë pohuar se fëmija e tyre ndjek klasën e dhjetë, 35.4% (N=24) klasën e njëmbëdhjetë, 17.7% (N=17) klasën e dymbëdhjetë dhe 19.8% (N=19) klasën e trembëdhjetë. 92.7% (N=89) e prindërve janë të kënaqur me cilësinë e komunikimit me shkollën, dhe 71.9% (N=69) kanë pohuar se e vlerësojne si shumë të mirë imazhin që ka institucioni në qytetin e tyre.

Tabela 1: Numri i pyetësorëve të plotësuar për secilin target grup

Përfituesit	**2025**	**2026**
Nxënës	226	332
Mësues	41	21
Prindër	319	94
Biznese	39	48

Rezultatet

Seksionet më poshtë përmbledhin rezultatet e matjeve me nxënësit, mësuesit, prindërit dhe bizneset. Ndërkohë, listën e plotë të gjetjeve për cdo pyetësor e gjeni në Shtojcën 1.

Zhvillimi i vazhduar profesional

76.2% e mësuesve kanë vlerësuar se aktivitetet e zhvillimit të vazhduar profesional janë në përputhje me nevojat e tyre, ndërsa e njëjta përqindje ka pohuar se aftësitë e tyre janë përmirësuar falë trajnimeve dhe aktiviteteve të parashikuara. Gjithashtu, 85.7% e mësuesve janë shprehur të kënaqur me mbështetjen e marrë gjatë zbatimit të planit, dhe 71.4% raportojnë se i aplikojnë në procesin e mësimdhënies njohuritë dhe metodat e reja të fituara. Nga ana tjetër, 88.6% e nxënësve kanë vlerësuar pozitivisht metodat e

përdorura në mësimdhënie, 85.5% janë të kënaqur me cilësinë e përgjithshme të tyre, ndërsa 77.1% janë shprehur të kënaqur me shpeshtësinë e ndërveprimit gjatë procesit mësimor.

Tabela 2: Rezultatet për treguesit e zhvillimit të vazhduar profesional

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025	Rezultati 2026
Mësuesit e kulturës profesionale – përfitues direkt	1. Aktivitetet e ZHVP janë në përputhje me nevojat e mësuesve.	63.4%	76.2%
	2. Aftësitë e mësuesve janë përmirësuar nga trajnimet/aktivitetet e parashikuara në planin e ZHVP.	82.5%	76.2%
	3. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë gjatë zbatimit të planit të ZHVP.	89.5%	85.7%
	4. Mësuesit aplikojnë në mësimdhënie njohuritë aftësitë, shprehitë dhe metodat e reja të mësimdhënies që kanë mësuar në trajnime dhe shkëmbime.	57.5%	71.4%
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e mësimdhënies (si p.sh., puna në grup, puna me projekte, përdorimi i teknologjisë, ndërveprimi në klasë etj.).	73.9%	88.6%
	2. Nxënësit janë të kënaqur me metodat e përdorura gjatë procesit të mësimdhënies.	53.4%	85.5%
	3. Nxënësit janë të kënaqur me shpeshtësinë e ndërveprimit gjatë procesit mësimor.	70.4%	77.1%

Kurrikula

81.0% e mësuesve kanë pohuar se e kanë më të lehtë zbërthimin e kurrikulës në përputhje me nevojat rajonale të tregut të punës, ndërsa e njëjta përqindje ka shprehur kënaqësi edhe për mbështetjen e ofruar nga koordinatori i kurrikulës në zbatimin e mësimdhënies. Nga ana tjetër, 86.1% e nxënësve besojnë se programi mësimor është i përshtatur me tregun e punës, duke reflektuar lidhjen mes arsimit dhe kërkesave të tregut. Edhe bizneset kanë dhënë vlerësime pozitive: 89.6% janë të kënaqura me njohuritë dhe aftësitë e nxënësve, si dhe e njëjta përqindje mendojnë se planet e praktikës profesionale janë në përshtatje me nevojat e tyre.

Tabela 3: Rezultatet për treguesit e kurrikulës

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025	Rezultati 2026
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit e kanë më të lehtë zbërthimin e kurrikulës në përputhje me nevojat rajonale të tregut të punës.	58.5%	81.0%
	2. Mësuesit janë të kënaqur me mbështetjen që kanë marrë nga koordinatori i kurrikulës për zbatimin e mësimdhënies	82.9%	81.0%

Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit mendojnë se programi mësimor është e përshtatur me tregun e punës.	84.8%	86.1%
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset janë të kënaqur me njohuritë, aftësitë dhe shprehitë që kanë marrë nxënësit në shkollë.	91.9%	89.6%
	2. Bizneset mendojnë se planet e praktikës profesionale janë në përshtatje me nevojat e tyre.	65.8%	89.6%

Marrëdhënia me biznesit

65.7% e nxënësve kanë marrë pjesë në praktikë profesionale në biznese, ku 60.5% prej tyre janë shprehur të kënaqur me mundësitë e ofruara nga shkolla për praktikë profesionale, ndërsa 61.7% janë shprehur të kënaqur me realizimin e praktikës sipas planit të përcaktuar. Nga ana tjetër, bashkëpunimi me bizneset paraqitet i larmishëm: 97.9% e tyre bashkëpunojnë me shkollën në forma të ndryshme, por vetëm 68.8% janë plotësisht të kënaqura me këtë bashkëpunim, dhe raportojnë bashkëpunim të ngushtë. Megjithatë, 97.9% e bizneseve janë të kënaqura me cilësinë e përgatitjes së nxënësve, 95.8% mendojnë se shkolla përmbush nevojat për aftësi cilësore pune, ndërsa 85.4% dhe 81.3% njohin respektivisht programin mësimor dhe modulet profesionale që ajo ofron.

Tabela 4: Rezultatet për treguesit e marrëdhënieve me biznesin

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025	Rezultati 2026
Nxënësit – përfitues direkt	1. % e nxënësve që kanë bërë praktikë profesionale në biznes.	95.2%*	65.7%*
	2. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me mundësitë që ofron shkolla për praktikë profesionale në biznes.	84.9%	60.5%
	3. Niveli i kënaqësisë së nxënësve me realizimin e praktikës profesionale në biznes sipas planit të praktikës.	84.9%	61.7%
Bizneset – përfitues direkt	1. Bizneset bashkëpunojnë në forma të ndryshme me shkollën.	83.9%	97.9%
	2. Bizneset janë të kënaqura për bashkëpunimin me shkollën.	57.7%	68.8%
	3. Bizneset bashkëpunojnë ngushtë me shkollën.	39.5%	68.8%
	4. Bizneset janë të kënaqur me cilësinë e përgatitjes së nxënësve nga shkolla.	91.9%	97.9%
	5. Bizneset mendojnë se shkolla përmbush nevojat e biznesit për aftësi cilësore pune.	83.8%	95.8%
	6. Biznesi njeh programin mësimor që ofron shkolla.	58.3%	85.4%
	7. Biznesi njeh shumë mirë modulet profesionale qe ofron shkolla.	56.8%	81.3%

*Shënim: (klasa XI – XIII)

Orientimi në karrierë

93.7% e nxënësve kanë përfituar shërbime për orientim në karrierë dhe 78.0% janë shprehur të kënaqur me cilësinë e këtyre sesioneve. Megjithatë, vetëm 73.8% ndihen të informuar mbi shanset e punësimit pas diplomimit në profilin që studiojnë. Nga ana tjetër, 76.0% e prindërve kanë vlerësuar pozitivisht shërbimin që shkolla ofron për orientimin në karrierë të fëmijëve të tyre, ndërsa 72.9% besojnë se ky orientim i ka ndihmuar fëmijët të marrin vendime të duhura për rrugën e tyre profesionale.

Tabela 5: Rezultatet për treguesit e orientimit në karrierë

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025	Rezultati 2026
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit kanë marrë shërbime të ndryshme për orientimin në karrierë.	89.7%	93.7%
	2. Nxënësit janë të kënaqur me cilësinë e shërbimit të ofruar në sesionet e orientimit në karrierë.	81.7%	78.0%
	3. Nxënësit janë të informuar për shanset e punësimit pas diplomimit në profilin që po studiojnë.	51.7%	73.8%
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit janë të kënaqur me shërbimin për orientim në karrierë që i jep shkolla fëmijës.	82.5%	76.0%
	2. Prindërit besojnë se orientimi në karrierë e ka ndihmuar fëmijën për të marrë vendimet e duhura për karrierën.	79.7%	72.9%

Projektet

90.5% e mësuesve kanë pohuar se njohin projektet zhvillimore të shkollës dhe 61.9% mendojnë se ato përmirësojnë cilësinë e arsimit. Përfshirja e tyre është gjithashtu e dukshme, pasi 81.0% marrin pjesë në hartimin e projekteve dhe 52.4% në zbatimin e tyre. Nga ana tjetër, 51.8% e nxënësve janë në dijeni të projekteve zhvillimore, ndërsa 22.9% janë të përfshirë drejtpërdrejt në to. Për sa i përket kënaqësisë, 19.6% shprehen të kënaqur me përfshirjen e tyre në aktivitete, ndërsa 19.3% janë të kënaqur me rezultatet e projekteve të zbatuara nga shkolla.

Tabela 6: Rezultatet për treguesit e projekteve

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025	Rezultati 2026
Mësuesit – përfitues direkt	1. Mësuesit i njohin projektet zhvillimore të shkollës	79.5%	90.5%
	2. Mësuesit mendojnë se projektet zhvillimore të shkollës përmirësojnë cilësinë e arsimit	66.7%	61.9%
	3. Mësuesit janë të përfshirë në shkrimin e projekteve zhvillimore si pjesë e grupeve të punës	63.4%	52.4%*

	4. Mësuesit janë të përfshirë zbatimin e projekteve zhvillimore.	70.7%	52.4%*
Nxënësit – përfitues direkt	1. Nxënësit janë në dijeni të projekteve zhvillimore në shkollë.	67.0%	51.8%
	2. Nxënësit janë të përfshirë në projekte zhvillimore	62.5%	22.9%
	3. Nxënësit janë të kënaqur me përfshirjen në aktivitete të projekteve të zhvilluara nga shkolla.	70.4%	19.6%
	4. Nxënësit janë të kënaqur me rezultatet e projekteve të zbatuara nga shkolla.	73.0%	19.3%

Shenim: Treguesit 3 dhe 4 janë llogaritur vetëm për mësuesit që raportuan pjesëmarrje në grupet e punës për projektet zhvillimore (N=11; 52.4% e kampionit total të shkollës).*

Marketingu

81.0% e mësuesve janë të kënaqur me aktivitetet e planit të marketingut të shkollës, ndërsa 57.1% vlerësojnë cilësinë e materialeve informuese. Përfshirja e tyre në këto aktivitete është disi më e ulët, me 66.7% që ndihen pjesë aktive. Nga ana tjetër, 75.3% e nxënësve janë të kënaqur me aktivitetet e marketingut, 70.2% mendojnë se materialet ofrojnë informacion cilësor dhe 85.8% shprehen pozitivisht për imazhin e shkollës, megjithatë vetëm 52.4% ndihen të përfshirë drejtpërdrejt. Bizneset shfaqin një vlerësim shumë të lartë, me 97.9% që e konsiderojnë shkollën si institucion me reputacion të mirë, ndërsa nga ana e prindërve, 71.9% e ndajnë të njëjtin mendim.

Tabela 7: Rezultatet për treguesit e marketingut

Mësuesit – përfitues indirekt	1. Mësuesit janë të kënaqur me aktivitetet e planit të marketingut të shkollës.	92.5%	81.0%
	2. Mësuesit mendojnë se materialet informuese për marketingun janë cilësore	97.6%	57.1%
	3. Mësuesit janë të kënaqur me imazhi që ka shkollë	90.2%	81%
	4. Mësuesit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut të shkollës.	61.5%	66.7%
Nxënësit – përfitues indirekt	1. Nxënësit janë të kënaqur me aktivitetet e marketingut të shkollës	66.3%	75.3%
	2. Nxënësit mendojnë se informacioni i dhënë në materialet e marketingut është cilësor.	79.1%	70.2%
	3. Nxënësit janë të kënaqur me imazhit të shkollës.	75.2%	85.8%

	4. Nxënësit ndihen të përfshirë në aktivitetet e marketingut.	34.0%	52.4%
Bizneset – përfitues indirekt	1. Bizneset e vlerësojnë shkollën si institucion me reputacion/ imazh të mirë.	94.7%	97.9%
Prindërit – përfitues indirekt	1. Prindërit e nxënësve të shkollës dhe nxënësve të klasave të 8-9 vlerësojnë shkollën si institucion me imazh të mirë.	73.5%	71.9%

Gjurmimi në nivel ofruesi

42.9% e drejtuesve dhe mësuesve kanë deklaruar se përdorin të dhënat e gjurmimit për të përmirësuar procesin mësimor dhe aktivitetet e lidhura me të. Po ashtu, 85.7% e shkollave i shfrytëzojnë këto të dhëna për përmirësimin e aktivitetit vjetor, çka tregon një nivel të lartë të përdorimit të informacionit për qëllime zhvillimore dhe planifikimi strategjik.

Tabela 8: Rezultatet për treguesit e gjurmimit në nivel ofruesi

Përfitues të shërbimit	Treguesit e cilësisë	Rezultati 2025	Rezultati 2026
Drejtuesi dhe Mësuesit – përfitues direkt	1. Drejtuesit dhe mësuesit përdorin të dhënat e gjurmimit për të përmirësuar procesin mësimor dhe aktivitetet e lidhura me të.	85.4%	42.9%
	2. Shkolla i përdor të dhënat e gjurmimit për përmirësimin e aktivitetit vjetor	78.0%	85.7%

Rekomandime për forcimin institucional

Rekomandimet e mëposhtme lidhen drejtpërdrejt me gjetjet e raportit për Shkollën Profesionale Teknike Korçë. Krahasimet për mësuesit duhen interpretuar duke marrë parasysh pjesëmarrjen e 21 personave në 2026, nga 41 në 2025. Për ndryshimet e mëdha dhe mospërputhjet në raport, hapi i parë është verifikimi i të dhënave dhe diskutimi me grupet përkatëse.

1. Të kuptohet rënia e pjesëmarrjes dhe kënaqësisë me projektet

Të verifikohen bazat dhe mënyra e llogaritjes së treguesve të nxënësve për projektet. Më pas, Njësia e Zhvillimit të diskutojë me nxënësit për mundësitë e pjesëmarrjes, përvojën gjatë aktiviteteve dhe dobinë e rezultateve.

Gjetja: Përfshirja e nxënësve në projekte ra nga 62.5% në 22.9%, kënaqësia me pjesëmarrjen nga 70.4% në 19.6% dhe me rezultatet nga 73.0% në 19.3%. Njohja e projekteve ra nga 67.0% në 51.8%. Madhësia e ndryshimeve kërkon verifikim para përcaktimit të veprimeve.

2. Të shqyrtohen mundësitë dhe organizimi i praktikës

Shkolla të identifikojë arsyet pse nxënësit nuk kanë kryer praktikë në biznes, duke marrë parasysh klasën dhe profilin. Me nxënësit që kanë kryer praktikë të diskutohen vështirësitë, ndërsa me bizneset të rishikohen organizimi, detyrat dhe ndjekja e planit.

Gjetja: Për nxënësit e klasave XI–XIII, pjesëmarrja në praktikë në biznes ra nga 95.2% në 65.7%. Kënaqësia me mundësitë e praktikës ra nga 84.9% në 60.5% dhe me realizimin sipas planit nga 84.9% në 61.7%. Ndërkohë, 89.6% e bizneseve i vlerësojnë planet si të përshtatura me nevojat e tyre.

3. Materiale informuese më të qarta dhe të përditësuara

Materialet e marketingut të rishikohen me mësuesit dhe nxënësit për të identifikuar informacionin që mungon ose kërkon qartësim. Përpara përdorimit, të kontrollohet saktësia e informacionit për profilet, praktikën dhe mundësitë pas diplomimit.

Gjetja: Vlerësimi i mësuesve për cilësinë e materialeve informuese ra nga 97.6% në 57.1%, ndërsa te nxënësit nga 79.1% në 70.2%. Në të njëjtën kohë, kënaqësia e nxënësve me aktivitetet e marketingut u rrit në 75.3%, ndaj përmirësimi duhet të fokusohet te përmbajtja e informacionit.

4. Gjurmimi të përdoret më shumë në procesin mësimor

Gjetjet e gjurmimit të prezantohen dhe të diskutohen në ekipet lëndore, duke përcaktuar ndryshime konkrete në përmbajtjen mësimore, detyrat praktike dhe orientimin në karrierë. Të dokumentohet si përdoren këto gjetje në punën e mësuesve.

Gjetja: Përdorimi i të dhënave të gjurmimit për përmirësimin e procesit mësimor ra nga 85.4% në 42.9%. Ndërkohë, vlerësimi se shkolla i përdor ato për përmirësimin e aktivitetit vjetor u rrit nga 78.0% në 85.7%. Dallimi kërkon sqarimin e mënyrës se si të dhënat kalojnë nga planifikimi në mësimdhënie.

5. Të rishikohet dobia e orientimit në karrierë për nxënësit dhe prindërit

Të mblidhen mendimet e nxënësve dhe prindërve për informacionin dhe mbështetjen që u nevojiten për vendimmarrjen. Sesionet të përfshijnë alternativa konkrete punësimi dhe studimi sipas profilit, si dhe mundësi për këshillim individual.

Gjetja: Megjithëse pjesëmarrja e nxënësve në orientim u rrit në 93.7% dhe informimi për punësimin në 73.8%, kënaqësia me cilësinë e sesioneve ra nga 81.7% në 78.0%. Te prindërit, kënaqësia me shërbimin ra nga 82.5% në 76.0% dhe besimi se ai ndihmon vendimmarrjen nga 79.7% në 72.9%.

Shtojca 1 – Tabela exel me të dhënat nga sondazhi

Shkolla Profesionale Teknike Korce_Indeksi